



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 21 mars 2011
Nr. ref.: RK96/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 02/10

Parashtruesi

Roland Bartetzko

**Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Gjykatës Supreme të
Kosovës, AP-KZ 181/2002, të 12 nëntorit 2002**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Roland Bartetzko. Ai është shtetas gjerman. Ai është duke vuajtur dënimin në Burgun e Dubravës, afër Istogut, Kosovë. Ai përfaqësohet nga Dr. Kolë Krasniqi nga Peja.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi S. C. AP-KZ 181/2002 i 12 nëntorit 2002 i Gjykatës Supreme të Kosovës.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pretendon që të drejtat e tij, të garantuara me nenin 30 (të drejtat e të akuzuarit), nenin 32 (e drejta për mjete juridike) dhe nenin 102.5 (e drejta e ankesës) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe të drejtat e tij të garantuara me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, janë shkelur. Ai pretendon që është privuar nga e drejta e tij themelore për ankesë, për shkak se avokati i tij mbrojtës gabimisht e ka njoftuar se ai nuk kishte të drejtë të parashtronte ankesë kundër dënimit të shqiptuar.
4. Ai gjithashtu kërkoi nga Gjykata shqiptimin e masës së përkohshme për ta rikthyer afatin ligjor të ankesës së tij kundër Aktgjyimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap. Nr. 181-2002, që ka marrë formën e prerë më tepër se gjashtë vjet para se Kushtetuta e Kosovës të hynte në fuqi.

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit, dhe rregulli 56 i Rregullores së punës.

Përmbledhja e fakteve

6. Më 10 maj 2002, Gjykata e Qarkut në Prishtinë e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për, ndër të tjera, veprën penale të terrorizmit sipas nenit 125 në lidhje me nenin 129 paragrafin 2 në lidhje me paragrafin 1 (të ndryshuar më 16 qershor 1993, Gazeta Zyrtare e RFJ-së Nr. 37-193) të Kodit Penal të Jugosllavisë. Gjykata konstatoi që më 18 prill 2001, parashtruesi i kërkesës kishte vendosur mjet shpërthyes para zyrave të Qendrës për Paqe dhe Tolerancë, ku punonin përfaqësuesit e ish-Jugosllavisë. Shpërthimi shkaktoi vdekjen e një zyrtari të lartë të Qeverisë së Serbisë. Katër anëtarë të tjerë të Qendrës gjithashtu u lënduan nga shpërthimi. Gjykata e dënoi z. Bartetzko me 23 vjet burg. (D. C. P. Nr. 1722-2001).
7. Më 12 nëntor 2002, Gjykata Supreme e Kosovës e ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut. Gjykata pjesërisht e miratoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe konstatoi që ai ishte fajtor për veprën penale të terrorizmit sipas nenit 125 në lidhje me nenin 139, paragrafin 2, të Kodit Penal të Jugosllavisë. Gjykata ia ndryshoi dënimin në 20 vjet burg, përfshirë kohën e kaluar në paraburgim nga 20 prilli 2001 (S. C. Ap. Nr. 181-2002).
8. Sipas parashtruesit të kërkesës, avokati i tij mbrojtës, Tomë Gashi, nuk kishte parashtruar ankesë kundër vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, as që e kishte njoftuar atë për të drejtën e tij për ankesë. Në vend të kësaj, ai i tha parashtruesit të kërkesës që nuk kishte të drejtë për ankesë. Pasi afati ligjor prej 15 ditësh për parashtrimin e ankesës mbaroi, vendimi mori formën e prerë.
9. Më 31 dhjetor 2002, parashtruesi i kërkesës pranoi një kopje të aktgjyimit të Gjykatës Supreme të Kosovës.
10. Pas mbarimit të afatit ligjor, z. Gashi kërkoi nga Gjykata Supreme ndryshimin e vendimit. Ai pretendonte që palët duhej të gëzonin të drejtën për ankesë për shkak se vendimi nuk përmbante mjet juridik.
11. Më 15 qershor 2003, parashtruesi i kërkesës revokoi autorizimin e avokatit, z. Gashi.

12. Më 8 korrik 2003, Gjykata Supreme tha lidhur me kërkesën për të drejtën për ankesë me sa vijon: “Kopje të vendimeve kundër të cilave lejohet ankesa duhet të dorëzohen bashkë me udhëzimet për të drejtën për ankesë”. Ajo gjithashtu tha: “Dështimi i gjykatës për t’ia dorëzuar palës, bashkë me vendim, udhëzimet e kërkuara për të drejtën për ankesë nuk paraqet rrethanë nën të cilën ligji nuk do të mund të merrej si arsye e bazuar që ankesa e dorëzuar jashtë afatit ligjor të konsiderohej si ankesë e dorëzuar brenda afatit ligjor”. (*Shih letrën e Gjykatës Supreme dërguar përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës, të 8 korrikut 2003*). Për më tepër, Gjykata Supreme e njoftoi parashtruesin e kërkesës se nuk mund ta pranonte kërkesën e tij sepse ishte parashtruar pas më tepër se gjysmë viti pas datës së pranimit të aktgjykimit.
13. Më 8 gusht 2003, parashtruesi i kërkesës kërkoi nëpërmjet avokatit të tij, z. Fazli Balaj, që Gjykata e Qarkut në Prishtinë ta rikthente afatin ligjor për ankesë. Më 6 janar 2004, Gjykata e Qarkut në Prishtinë e hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit të kërkesës për shkak se ishte parashtruar pas periudhës ligjore të paraparë me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 92 të Kodit Penal të Jugosllavisë.
14. Më 10 nëntor 2009, Prokurori i Shtetit i Kosovës njoftoi parashtruesin e kërkesës që kërkesa e tij drejtuar Gjykatës Supreme të Kosovës ishte refuzuar për shkak se i mungonte baza juridike.

Procedurat në Gjykatë

15. Parashtruesi i kërkesës e parashtrroi kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese më 7 dhjetor 2009. Parashtruesi i kërkesës e plotësoi kërkesën me argumente shtesë më 5 janar 2010, duke kërkuar nga Gjykata shqiptimin e masës së përkohshme për “rikthimin e afatit ligjor për ankesë”.
16. Më 13 maj 2010, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit Suroy dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë refuzimin e kërkesës për masë të përkohshme.
17. Më 16 gusht 2010, Gjykata Kushtetuese nxori një vendim me të cilin ia refuzonte kërkesën për masa të përkohshme.

Ankesat e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës ankohet se i është shkelur e drejta e tij për ankesë, e garantuar me nenin 102 të Kushtetutës dhe nenin 394 (1) të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale. Sipas tij, është shkelur edhe neni 30 i Kushtetutës, i cili i garanton të drejtat e të akuzuarit.
19. Parashtruesi i kërkesës pohon që atij i ishte mohuar e drejta për t’i ushtruar këto të drejta themelore. Vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, i 12 nëntorit 2002, nuk përfshinte këshillën juridike për të drejtën e tij për ankesë dhe kryetari i trupit gjykues nuk kishte ofruar udhëzime verbale. Për më tepër, avokati i tij mbrojtës i ka thënë që nuk ka të drejtë për ankesë. Vendimi i shqiptuar kundër tij mori formën e prerë vetëm për shkak se (1) avokati i tij mbrojtës i ofroi këshilla të gabuara; dhe (2) ai nuk ka pasur njohuri të gjuhëve zyrtare për ligjet e zbatueshme në Kosovë. Për këto arsye, ai nuk ka pasur mundësi të ushtronte të drejtën e tij për ankesë.
20. Së fundi, parashtruesi i kërkesës pretendon që kjo shkel Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës dhe Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës, si dhe Kushtetutën e Kosovës, të drejtën e Bashkimit Evropian, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut. Në mënyrë që kjo shkelje të korrigjohet, afati ligjor i ankesës së tij do të duhej të rikthehej.

Vlerësimi i pranueshmërisë të kërkesës

21. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës.
22. Parashtruesi i kërkesës mund të ankohet vetëm nëse gjykatat e rregullta kanë bërë lajthim të fakteve ose të ligjit, dhe nëse ato mund t'i kenë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë.
23. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e shkallës së katërt kur i shqyrton vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Gjykatat e rregullta kanë për detyrë t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, Aktvendimin për papranueshmëri në Rastin Nr. KI 13/09, Sevdail Avdyli, të 17 qershorit 2010, dhe *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës (GC), nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut 1999-I).
24. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse dëshmitë janë paraqitur në mënyrë të tillë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesi nuk ka pasur gjykim të drejtë (shih *mutatis mutandis* Raportin e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, kërkesa Nr. 13071/87, të miratuara më 10 korrik 1991).
25. Sa i përket rastit në fjalë, parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar që Gjykata Supreme e ka shkelur nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenin 30 të Kushtetutës.
26. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, “shteti nuk mund të konsiderohet përgjegjës për gabimet e avokatit të caktuar për ndihmë juridike apo të zgjedhur nga i akuzuari” (shih *Kamasinski kundër Austrisë, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 19 dhjetorit 1989, A nr. 168*).
27. Në të vërtetë, sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, “avokati, edhe nëse caktohet zyrtarisht për ta përfaqësuar një të akuzuar në procedurë penale, nuk mund të konsiderohet organ shtetëror. Prandaj, nga pavarësia e profesionit ligjor nga shteti rezulton që mbrojtja është çështje ndërmjet të pandehurit dhe avokatit të tij mbrojtës, qoftë i caktuar në bazë të skemës ligjore ose i financuar privatisht, dhe si i tillë, përveç në rrethana të jashtëzakonshme, nuk mund ta bartë përgjegjësinë e shtetit sipas Konventës (shih *mutatis mutandis* Artico kundër Italisë, Aktgjykimi i 30 majit 1980, Seria A nr. 37, f. 18, para 36; Daud kundër Portugalisë, Aktgjykimi i 21 prillit 1998, *Raportet e Aktgjykimeve dhe Vendimeve* 1998-II, f. 749, para 38; KEDNJ, nr. 9022/80, Vendim, 13.7.1983, D.R. 33, f. 21; nr. 27266/95, Vendim, 21.10.1996, D.R. 87-B, f. 100; *Tuziński kundër Polonisë* (Vendim), nr. 40140/98, 30.03.1999).
28. Sipas nenit 6, paragrafit 3 (c), shtetet nënshkruese kërkohet të ndërhyjnë vetëm nëse shihet qartë që avokati mbrojtës ka dështuar të ofronte përfaqësim efektiv apo kur shteteve u ishte tërhequr vëmendja për këtë (shih *Imbrioscia kundër Zvicrës, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 24 nëntorit 1993, A nr. 13972/88*).
29. Duhet të rikujtohet që Gjykata Supreme e shqyrtoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe gjeti se “dështimi i gjykatës për t’ia dorëzuar palës, bashkë me vendim, udhëzimet e kërkuara për të drejtën për ankesë nuk paraqet rrethanë nën të cilën ligji nuk do të mund të merrej si arsye e bazuar që ankesa e dorëzuar jashtë afatit ligjor të konsiderohej si ankesë e dorëzuar brenda afatit ligjor”.

30. Në tërësi, Gjykata konsideron që nuk ka asnjë dëshmi që tregon se avokati mbrojtës i parashtruesit të kërkesës ishte i pafektshëm.

31. Për këto arsye, Gjykata konstaton që kërkesa e parashtruesit të kërkesës është qartazi e pabazuar dhe duhet të hidhet poshtë si e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregullin 36 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese njëzëri

VENDOS


I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme.

Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligji për Gjykatën Kushtetuese.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues

Altay Suroy



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani